



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE




RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË TRETË
TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË UNIVERSITETIN E GJIROKASTRËS
"EDUKIMI DHE SHKENCAT HUMANE"

Miraturar në mbledhjen e SENATIT AKADEMIK të Universitetit "Eqrem Çabej",
Gjirokastrë, me Vendimin Nr. 22, datë 15.04.2024
Amenduar në mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" me Vendim
Nr. 18, datë 28.04.2025

Gjirokastrë



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë rregulla mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programit të përbashkët në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” në Edukim dhe Shkencat Humane, midis Universitetit “Eqrem Çabej” (në vijim UGJ) dhe Universitetit të Maqedonisë Perëndimore (në vijim UMP), në përputhje dhe me standardet evropiane të arsimit të lartë (EHEA).

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

1. Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligjin Nr. 4957/2022 “Për arsimin e lartë në Republikën e Greqisë”, Fletore Zyrtare A 141/21.7.2022.
3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
4. VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar.
5. Statutin dhe rregulloren e UGJ-së dhe aktet normative analoge të UMP-së.
6. Marrëveshjen e bashkëpunimit midis UMP-së dhe UGJ-së -Shqipëri, datë 22.06.2022.
7. Marrëveshjen specifike midis UGJ-së dhe UMP-së, për programin e përbashkët të doktoraturës, datë 20.12.2023
8. VKM Nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.
9. VKM Nr. 777, datë 26.12.2018 “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar.
10. Udhëzimin e MASR Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
11. Udhëzim Nr.11, datë 10.04.2017 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”.
12. Udhëzim nr. 10 , datë 16.6.2023 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.



13. Udhëzimin e MASR Nr. 16, datë 08.07.2019 *“Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”*.
14. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr. 20, datë 20.09.2019 *“Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”*.
15. Udhëzimin e MASR Nr. 29, datë 18.12.2019 *“Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”*.
16. Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.01.2020 *“Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”*.
17. Udhëzimin Nr.10, datë 30.03.2020 *“Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”*.
18. Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”*.
19. Vendim Nr. 128, datë 06.03.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 112, datë 23.02.2028, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës Shkencore ‘Doktor’ dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’”, të ndryshuar.*
20. Vendimin Nr. 128, datë 6.3.2024 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 112, datë 23.2.2028, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”, të ndryshuar.*
21. Vendimi 824, datë 24.12.2021 Për miratimin e e kodit të cilësisë së arsimit të lartë.

Neni 3

Objektivat e programit të studimit

1. Programi i studimit të doktoraturës përfshihet në ciklin e tretë të studimeve, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e përbashkët për gradën shkencore “Doktor”.
2. Programi i përbashkët i doktoraturës synon të nxisë kërkimin shkencor në fushën e Edukimit dhe Shkencave Humane/ nënfushat e caktuara, duke u orientuar drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit të njohurive shkencore, për të sjell një risi të mendimit shkencor.
3. Studimet e Doktoraturës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoraturës (disertacionit) të nevojshme për marrjen e gradës shkencore “Doktor” dhe lidhen me projekte kërkimore të njësisive bazë.



4. Programi i përbashkët i doktoraturës, ndërtohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkim shkencor, në nënfushat e përcaktuara nga njësitë bazë të UGJ-së në bashkëpunim me njësitë bazë të UMP-së.
5. Të dy strukturat bashkëpunuese (njësitë bazë respektive) shpallin nënfushat sipas objektivave të tyre ose fushave të përbashkëta ndërmjet tyre me prioritet për thellimin e kërkimit shkencor.

Neni 4

Të dhëna të përgjithshme për programin e doktoraturës

1. Në kuadër të këtij programi të përbashkët, edhe pse mund të aplikohet praktika ndërkombëtare, **standartet dhe kërkesat e arsimit të lartë shqiptar do të kenë peshën kryesore**, duke siguruar përputhshmërinë me ligjin nr. 80/2015 dhe aktet ligjore të tjera të Shqipërisë për pranimin, mësimdhënien, vlerësimin, dhe mbrojtjen e disertacionit.
2. Ky është një program i përbashkët studimi i arritur midis UGJ-së dhe UMP dhe fillon veprimtarinë akademike në vitin akademik 2024-2025.
3. Programi i përbashkët i doktoraturës ka natyrë ndërdisiplinore dhe ofrohet nga grupimi i njëjësive bazë të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në UGJ dhe nga njësitë bazë të Shkollës së Shkencave Sociale dhe Humane në UMP.
4. Programi i studimit të Doktoraturës realizohet në mjediset e të dy universiteteve bashkëpunuese, të cilët vënë në dispozicion të realizimit të tij të gjitha asetet e disponueshme.
5. Programi i studimit administrohet dhe financohet nga UGJ. Të dy instucionet interesohen për gjetjen e burimeve të tjera financuese.
6. Çdo palë bashkëpunuese në program respekton legjislacionin përkatës të vendit të vet, pa lejuar cënimin e legjislacionit të palës tjetër.
7. Në kushtet e realizimit të këtij programi të përbashkët me një institucion të arsimit të lartë me një institucion të huaj, mund të zbatohen standarte të ndryshme nga ato shtetërore.
8. Programi drejtohet nga Dekanatet e të dy Fakulteteve respektive dhe koordinohet nga Komiteti i Përbashkët Koordinues i Programit të Studimit (në vijim KPKPS) me përfaqësues nga të dy universitetet, në raportin 3 përfaqësues nga UGJ dhe 2 përfaqësues nga UMP.
9. Gjuha e zhvillimit të programit të përbashkët të studimit është gjuha angleze.
10. Bashkëudhëheqja e një disertacioni bëhet nga 1 përfaqësues nga të dy universitetet partnere të kategorisë “Profesor” nga UGJ dhe Dr ose “Profesor” nga UMP.
11. Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore “Doktor” realizohet nga juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim.



Neni 5
Organizimi i programit të përbashkët të Doktoraturës

1. Njësitë bazë të UGJ-së dhe UMP-së në bashkëpunim formulojnë propozimin për hapjen e programit të përbashkët të studimeve të doktoratës, kur plotëson kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë :
 - a. ka personel akademik me titull “Profesor i asociuar” ose “Profesor”;
 - b. ka numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit;
 - c. ka struktura administrative dhe kërkimore për veprimtaritë e parashikuara nga programi i studimit të doktoratës (laboratorë, biblioteka dhe infrastrukturën e nevojshme);
 - d. ka burime financiare mbështetëse.
2. Dekanati i UGJ-së, i paraqet Senatit Akademik propozimin për hapjen e programit të përbashkët të doktoratës, i cili formulohet sipas kërkesa të legjislacionit në fuqi dhe përmban:
 - a. Fushën/nënfishën e kërkimit shkencor dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës;
 - b. Afatet kohore të realizimit të programit;
 - c. Fondet financiare për realizimin e procesit të studimit, përfshirë edhe mundësinë vetëfinancimit ose të granteve për projekte kërkimore;
 - d. Parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programin e përbashkët të doktoratës, i cili përcaktohet në përputhje me kapacitetet e njësisë kryesore;
 - e. Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat miratohen nga njësia kryesore në përputhje me aktet ligjore/ nënligjore dhe sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë/të përafërt me studimet e ciklit të parë ose të dytë;
 - f. Personelin akademik, që do të realizojë udhëheqjen e doktorantëve miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore.
3. Programi i përbashkët i ciklit të tretë të studimeve të doktoratës “Edukimi dhe shkencat humane” në UGJ, në bashkëpunim me UMP, është pjesë përbërëse e grupimit të njësive bazë të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (në vijim FESHSH) të UGJ-së, si edhe të strukturës analoge të institucionit partner, sipas parashikimeve të marrëveshjes specifike ndër-institucionale.
4. Funkcionimi i programit për realizimin e disertacioneve përcaktohet nga objektivat e programit në tërësi dhe të fushave përbërëse në veçanti, që synojnë:
 - a. realizimin e kërkimit shkencor origjinal, të mirëfilltë, novator e të drejtëpërdrejtë, në fushat e përfshira në programin e studimit;
 - b. promovimin dhe kualifikimin i njohurive shkencore;
 - c. sjelljen e risive të reja në mendimin shkencor, duke u orientuar drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe riintegrit të kërkimit shkencor;
 - d. kontributin e drejtëpërdrejtë në veprimtarinë akademike të institucioneve partnere;



- e. njohjen më të mirë dhe më të thellë si dhe me bazë shkencore të realiteteve arsimore, kulturore, gjuhësore dhe të traditës, për rajonin dhe më gjerë.
5. Veprimtaria e programit të studimit bazohet në parimet e ligjshmërisë, autonomisë, efektivitetit akademik e kërkimit shkencor, respektimit të rregullave të etikës në punën kërkimore-shkencore, drejtuese dhe bashkëpunuese me njësitë dhe struktura të tjera akademike/administrative në UGJ-së dhe në UMP-së .
6. Institucionet ofruese të programit të studimeve të doktoratës garantojnë standardet akademike dhe ofrojnë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e projekteve individuale kërkimore-shkencore.
7. Studimet e doktoratës organizohen në kuadër të një projekti kërkimor-shkencor dhe zhvillimit dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit brenda njësisë kryesore/bazë, ku mund të aplikohet për financim pranë AKKSHI-së ose pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare.
8. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, kandidati mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo edhe të vetëfinancohet.

KREU II

Struktura dhe drejtimi i programit të studimit

Neni 6

Struktura e programit

1. Programi i ciklit të tretë të studimeve të doktoratës “Edukimi dhe Shkencat Humane” në UGJ, është një program i përbashkët dhe realizohet në bashkëpunim me UMP - Greqi.
2. Programi ka dy fusha përbërëse kërkimi apo studimi, atë të Edukimit dhe të Shkencave Humane. Me qëllim garantimin e formimit akademik e shkencor të doktorantëve, fusha përkatëse e studimit, përmban veprimtari kërkimore-shkencore.
3. Programi i studimit i referohet nivelit 8 të KSHK-së. Ai ka natyrë ndërdisiplinore dhe ofrohet nga grupimi i njësisive bazë në FESHSH: Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies; të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek; të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë; të Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë, Gjuhëve të huaja të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në UGJ dhe të njësisive bazë: të Arsimit fillor, të Edukimit të Fëmijërisë së Hershme, të Psikologjisë dhe të Komunikimit dhe Mediave Digitale të Shkollës së Shkencave Sociale dhe Humane të UMP - Greqi.
4. Studimet e programit zhvillohen me kohë të plotë ose kohë të zgjatur. Studimet e programit me kohë të zgjatur, mund ti ndjekë, kandidati që është punësuar si personel akademik në një institucion të Arsimit të Lartë, personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë/zbatuar dhe institucione të arsimit parauniversitar.
5. Grada shkencore “Doktor” fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit, sipas kriterëve në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
6. Diploma e gradës shkencore Doktor është e përbashkët me logot e të dy institucioneve dhe nënshkrimin e autoriteteve të dy institucioneve partnere.



Neni 7
Afatet e studimeve të doktoratës

1. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se 3 (tri) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.
2. Në rastet e veçanta dhe të arsyetura, pas kërkesës së doktorantit, të aprovuar nga grupi bashkëudhëheqës dhe të miratuar nga Dekanati i UGJ-së, afatet mund të ndryshojnë.
3. Në raste përjashtimore, me kërkesë të studentit, Dekanati i UGJ-së, mund të vendosë vetëm një herë për shtyrjen ose për pezullimin e studimeve të doktoratës, por jo më shumë se 2 (dy) vite në total.

Neni 8
Drejtimi i programit

1. Drejtohet nga Dekanët respektive të të dy institucioneve partnere.
2. Çdo institucion bashkëpunues për programin e përbashkët ngre strukturat e veta drejtuese dhe koordinuese në kuadrin e fakulteteve përgjegjëse për implementimin e programit. Kjo strukturë janë Dekanatet respektive, ose secili universitetet mund të angazhojë si strukturë e re me staf akademik të kategorisë “profesor” të zgjedhur nga Dekanati i fakultetit përkatës.
3. Dekanati i FESHSH-së është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të përbashkët të studimit. Njësitë bazë janë përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e programit të përbashkët të studimit.
4. Kriteret e pranimit të studentëve për në programin e përbashkët të studimeve të doktoratës përcaktohen nga njësitë bazë në bashkepunim me të dy universitetet, i përcillen Dekanatit për miratim.
5. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili monitoron procesin për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë me titull akademik “Profesor” që miratohen nga Senati Akademik.
6. Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore “Doktor” realizohet nga juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim, e cila propozohet nga njësitë bazë sipas fushave përkatëse të studimit dhe miratohet nga Komisioni i Përhershëm i Gradës Shkencore “Doktor”

Neni 9
Komiteti i Përbashkët Koordinues i Programit të Studimit

1. KPKPS- ja menaxhon dhe koordinon zbatimin e ligjshmërisë për programin e studimit në të gjitha drejtimet dhe instancat e tij;
2. Koordinon/informon universitetin partner për procedurat që ndiqen për programin e studimit.



3. KKPS-ja në mënyrë të vazhdueshme kryen takime dhe përcjell vendimarrjet përkatëse të secilit universitet për vijimin e procedurave për programin e përbashkët
4. Organizon në bashkëpunim me organet drejtuese të institucionit ceremonitë për dhënien e diplomave të doktorantëve që përfunduan me sukses mbrojtjen e disertacionit.
5. Pasqyron në raporte vlerësimi ecurinë e proceseve të Doktoraturës dhe ia kalon universitetit partner për vendimarrjen e universitetit partner.
6. Informon Senatit Akademik të UGJ-së dhe Komisionin e Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore Doktor për të gjitha procedurat, afatet dhe zbatimin e tyre për këtë program studimi.

Neni 10

Kompetencat e Dekanatit për programin e studimit

1. Dekanati i FESHSH-së për programin e përbashkët të studimit të doktoratës ka këto kompetenca:
 - a. Pas propozimeve të ardhura nga njësitë bazë pjesëmarrëse në program, miratojnë projektet individuale kërkimore-shkencore.
 - b. Kriteret e pranimit të studentëve sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë/ të përafërt me studimet e cikleve paraardhës.
 - c. I përcjell Senatit Akademik për miratim projekt-propozimet individuale fituese, kriteret, kuotat dhe i shpall publikisht.
 - d. Shpallja publike ndodh pas verifikimit dhe certifikimit të kapaciteteve pritëse të institucionëve bashkëpunuese nga ministria përgjegjëse për arsimin.
 - e. Shpall procedurat, afatet, kriteret dhe dokumentat për aplikim të kandidatëve doktorantë.
 - f. Ngre komisionin *ad-hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve mbi bazën e dokumentacionit në dosjen përkatëse, dhe bën klasifikimin e tyre.
2. Nëse një kandidat ka aplikuar për më shumë se një program individual dhe u shpall fitues në më shumë se një prej tyre, vendimi për zgjedhje i takon kandidatit.
3. Shpall procedurat e regjistrimit të aplikantëve bashkë me detyrimet dhe dokumentacionit zyrtar të aplikimit.
4. Shpall kandidatët pas përfundimit të vlerësimit dhe renditjes së tyre nga komisioni *ad-hoc*.
5. I propozon KPKPS-së koordinimin e vendosjes së kontakteve të para midis stafit akademik udhëheqës dhe kandidatit përkatës.
6. Pas verifikimit dhe certifikimit të kapaciteteve dhe kuotave nga ministria përgjegjëse për arsimin për vitin akademik, u kërkon njësitë bazë të propozojnë kriteret, kuotat dhe projektet individuale për vitin pasardhës.
7. Pas propozimeve të ardhura nga njësitë bazë pjesëmarrëse në program, përcakton numrin për çdo fushë kërkimi apo studimi dhe atë total.
8. I përcjell për aprovim dhe shpallje Senatit Akademik kriteret e pranimit dhe numrin e kandidatëve për programin e studimit për vitin pasardhës.



9. Bashkërendon në bashkepunim me KPKPS-në dhe Koordinatorin e Programit të Studimit, në funksion të realizimit të projektit kërkimor-shkencor individual, veprimtarinë akademike të studentëve.
10. I propozon Senatit Akademik ndryshime dhe amendime në këtë rregullore me qëllim organizimin dhe funksionimin sa më efektiv të programit të doktoratës.
11. Miraton personelin akademik që do të angazhohet me udhëheqjen e një doktorature.
12. Miraton projekt propozimet individuale të ardhura nga njësitë bazë.
13. Dekanati përgjegjës për programin e doktoratës, administron të dhënat e çdo kandidati dhe doktoranti, në lidhje me veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të tij, si dhe raportet e vlerësimit të progresit:
 - a. Ndjek nga afër procesin e kërkimit shkencor të doktorantit dhe zgjidh, kur është e nevojshme, probleme që kanë të bëjnë me ecurinë, përparimin dhe etikën e doktorantit.
 - b. Vendos kur studimet e doktoratës ndërpriten, shtyhen ose pezullohen dhe vendimin e vet ia Senatit Akademik për miratim.
 - c. Shqyrton kërkesën për shtyrjen e afateve të studimeve të doktoratës. Kërkesa me arsyet objektive paraqitet e nënshkruar nga kandidati dhe udhëheqësi.
 - d. I përcjell propozimin e tij Bordit të Administrimit të Univesitetit për afatet e pagesës për të gjithë ciklin e programit.
 - e. Dekanati pas rendidjes së kandidatëve fitues nga komisioni Ad-hoc, miraton listën përfundimtare të fituesve dhe e bën publike atë, ia përcjell Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore Doktor.

Neni 11

Kompetencat e njësisë/njësisive bazë pjesëmarrëse në programin e studimit të doktoraturës

1. Njësia/njësitë bazë pjesëmarrëse në program, i propozon Dekanatit numrin e vet të programeve individuale të doktoraturës.
2. I propozon Dekanatit kriteret e pranimit të studentëve sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit paraardhës.
3. Harton dhe i paraqet Dekanatit programet individuale të studimit doktoratë.
4. Paraqet listën e personelit akademik dhe deklaratën e tij të angazhimit në udhëheqje doktorature.
5. Merr pjesë aktivisht, në funksion të realizimit të projekteve kërkimore-shkencore, në veprimtarinë akademike të studentëve doktorantë.
6. Parashikon në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit/ve individuale të doktoratës nën kompetencën e vet.
7. Drejton punën për hartimin e raporteve të vlerësimit të progresit dhe i aprovon.
8. Bën vlerësimin vjetor dhe përfundimtar të ecurisë së kandidatëve, në procesin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor individual;



9. Njësia bazë në bashkëpunim me asistenten e Dekanit protokollon vlerësimin e ecurisë vjetore të kandidatit.



Neni 12

Përbërja dhe kompetencat e Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor

1. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" është komision i përhershëm që ngrihet në nivel njësie kryesore ose Institucioni. Ai monitoron gjithë procesin për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
2. Mandati i tij është 2-vjeçar dhe mund të zgjidhet në kuadrin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UGJ në rastet kur është komision i përhershëm i Fakultetit ose zgjidhet nga Senati Akademik kur është në rang institucional.
3. Në rastet kur është komision i përhershëm pranë fakultetit, ai zgjidhet nga Asambleja e stafit akademik të FESHSH-së dhe përbëhet nga pesë anëtarë të kategorisë "Profesor" që kanë më shumë se 5 vjet punë si personel akademik.
4. Në rastet kur është komision i përhershëm në rang institucional, ai zgjidhet nga Senati Akademik pas shqyrtimit të aplikimeve për këtë komision të anëtarëve të stafit akademik të kategorisë "Profesor"
5. Komisioni merr në listën e fituesve të përcjellë nga shqyrtim i dosjeve për kandidatët fitues për gradën "Doktor" dhe nëse e vlerëson pozitivisht dhe të plotë kërkon dhe vendos ngritjen e jurisë dhe fillimin e procedurave sipas parashikimeve në këtë rregullore:
 - a. ndjek detyrimet që kandidati duhet të plotësojë përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së disertacionit;
 - b. përcakton afatet për procesin e mbrojtjes së tezës së disertacionit të një doktorature;
 - c. ngre juri për vlerësimin e tezave të disertacionit, me propozim të njësisë bazë së cilës i takon doktoranti dhe programit individual i doktoratës;
 - d. përgatit raportet vlerësuese, relacionin përfundimtar si dhe dokumentat përfundimtare të miratuar nga Dekanati, për dhënien e gradës "Doktor";

Neni 13

Juria për mbrojtjen finale të doktoraturës, përbërja dhe kompetencat

1. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor" ngrihet nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
2. Ka në përbërje 5 anëtarë, nga të cilët, të paktën 2 (dy) anëtarë u përkasin grup njësisive bazë të dy institucioneve bashkëpunuese si dhe zgjedh kryetarin e saj.
3. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njësisive bazë të dy institucioneve bashkëpunuese.



4. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësia bazë, me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 6 (gjashtë) dhe në rast pamundësie pjesëmarrjeje në mbrojtje të një anëtari të përzgjedhur, ai zëvendësohet nga Komisioni, nga anëtari vijues i propozuar nga njësia bazë. Vendimi mund të shoqërohet dhe me ndryshimin e datës për mbrojtjen e doktoraturës.
5. Juria pas procedurave për mbrojtjen e disertacionit harton raportin vlerësues dhe ia dërgon atë Komisionit për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor".

Neni 14

Koordinatori i programit të studimit

1. Programi i përbashkët i studimit të doktoratës "Edukimi dhe shkencat humane" ndiqet nga Koordinatori i Programit të Studimit, i cili zgjidhet ndërmjet anëtarëve të personelit akademik të Fakultetit që kanë titull akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" i cili ka këto kompetenca:
 - a. Kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqësin/bashkëudhëheqësin shkencor, sipas rregullave.
 - b. Garanton komunikimin dhe koordinimin midis udhëheqjes shkencore dhe doktorantit, midis autoriteteve dhe strukturave drejtuese të programit, midis institucioneve partnere në program;
 - c. Angazhohet për vënien në dispozicion të doktorantëve, të infrastrukturës së nevojshme për kërkim dhe studim të universiteteve partnere;
 - d. Angazhohet për njohjen nga doktorantët të legjislacionit, parimeve profesionale dhe etike të kërkimit shkencor.
 - e. I paraqet Dekanateve respektive të insitucioneve partnere relacion me shkrim për ecurinë e programit të Doktoraturës, në cilësinë e anëtarit të KPKPS-së.

KREU III

STUDIMET DOKTORALE

Neni 15

Struktura, përmbajtja dhe ecuria e studimeve të programit

1. Studimet e programit të përbashkët të doktoratës zhvillohen me kohë të plotë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar she në institucionet e Arsimit parauniversitar.
2. Studimet, kërkimi shkencor dhe puna hartuese e doktoraturës mund të zhvillohen paralelisht në dy institucionet bashkëpunuese në program. Kjo varet nga tema e doktoraturës dhe objektivat që synon të arrijë. Në çdo rast ndiqen modalitetet e përcaktuara me ligj, statutin dhe rregulloren e UGJ-së dhe në këtë rregullore.
3. Studimet e doktoratës organizohen në dy fusha kërkimi: të edukimit dhe të shkencave humane. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese si dhe



përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore. Fushat dhe kategoritë e veprimtarive përcaktohen në programin e studimit individual nga udhëheqja përkatëse dhe u referohen akteve normative rregulluese të Këshillit të Ministrave dhe të ministrisë përgjegjëse të arsimit si edhe kanë për qëllim garantimin e formimit akademik shkencor në fushën përkatëse të studimit.

4. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi projekte individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga programi i studimit. Ato përfshihen në dy kategori:
 - a. Programet e doktoratës me lëndë (tema/disertacione) të strukturimit të kërkimit shkencor të thelluar, metodave cilësore dhe sasore të përpunimit të të dhënave, etikës së kërkimit shkencor dhe shkrimit të punimeve shkencore e të disertacionit doctoral.
 - b. Programet e doktoratës me lëndë (tema/disertacione) të avancuara të debateve teorike, përqsjeve kërkimore, bashkëpunimeve ndërdisiplinore dhe zhvillimeve të fundit të disiplinës shkencore të doktorantit.
5. Ecuria për realizimin e disertacionit mbështetet mbi raportet e vlerësimit progresiv. Për çdo fazë duhet të ketë të paktën një raportvlerësimi progresiv. Raportet e mësipërme vlerësohen dhe aprovohen në njësinë bazë dhe bëhen pjesë integrale e dosjes së kandidatit.
6. Kritere për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve hartohen nga njësinë bazë pjesëmarrëse në program, miratuar nga Dekanati.
7. Programi zhvillohet në mjediset akademiko-shkencore të dy institucioneve të arsimit të lartë bashkëpunuese në program. Mënyra e lëvizjes së studentëve doktorantë dhe e stafit akademik udhëheqës për realizimin e doktoraturës, zgjidhet nga autoriteti i UGJ-së, konform akteve ligjore në fuqi dhe parashikimeve financiare të përcaktuara në programin e studimit.

Neni 16

Udhëheqja e doktoraturës

1. Udhëheqja e doktoraturës të një kandidati për doktoraturë përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë. Fakultetet bashkëpunuese në program përfaqësohen me të paktën një anëtar në çdo udhëheqje shkencore.
2. Udhëheqja përzgjidhet nga personeli akademik i kategorisë "Profesor". Mund të jenë anëtarë të njësinë bazë pjesëmarrëse në program, prej dy institucioneve.
3. Udhëheqja shkencore harton projektin individual të disertacionit i cili aprovohet nga njësinë bazë dhe i përcillet Dekanatit për miratim.
4. Projekti përmban:
 - a. temën e disertacionit;
 - b. përmbajtjen e shkurtër;
 - c. qëllimin dhe objektivat;
 - d. metodat që do të përdoren;
 - e. impakti i pritshëm;
 - f. struktura paraprake e disertacionit (punimi i doktoraturës);



- g. burimet bibliografike të rekomanduara.
5. Çdo anëtar i stafit akademik të njësive bazë që do të angazhohet me udhëheqje doktorature, lëshon një deklaratë angazhimi.
 6. Udhëheqja e doktoraturës ndjek nga afër gjithë punën e doktorantit, respekton pavarësinë e tij studimore, hartuese dhe krijuese.
 7. Udhëheqja i bën me dije doktorantit penalitet në rast të shkeljes së etikës së kërkimit-shkencor.
 8. Udhëheqja e doktoraturës shprehet në raportet e vlerësimit progresiv dhe në mbrojtje të doktoraturës para jurisë vlerësuese.

Neni 17 Doktoranti

1. Ka të drejtë të përfshihet në këtë program të përbashkët studimi çdo individ që plotëson kriteret e pranimit të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në këtë rregullore.
2. Programi nuk vendos kufizime sa i përket shtetësisë dhe kombësisë së kandidatit.

Neni 18 Kriteret e pranimit të një studenti në programin e përbashkët të studimit të doktoraturës

1. Kriteret e pranimit të një studenti në programin e studimit hartohen nga njësitë bazë të FESHSH-së në bashkëpunim me Njësitë Bazë të UMP, dhe i propozohen Dekanatit për miratim . Miratimi përfundimtar bëhet nga Senati Akademik i UGJ-së dhe i bëhen të njohura zyrtarisht nga Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin.
2. Kriteret e pranimit miratohen çdo vit nga Senati Akademik pas propozimeve të njësive bazë të miratuara nga Dekanati përkatës në komunikim me palën bashkëpunuese .
3. Për të kryer regjistrimin në programin e përbashkët të studimeve të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kriteret:
 - a. Të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, arsimit parauniversitar, të jetë personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
 - b. Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve” apo një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit (e vlefshme kjo edhe për kandidatët nga vendi i Institucionit partner në projekt, apo dhe vendeve të tjera të BE-së), të shoqëruara me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin.
 - c. Diploma “Master i shkencave” mund të përbëjë vijimësi me fushat dhe nënfushat e programit të studimit, apo të jetë e përafërt me to.



- d. Të ketë mbrojtur të paktën në nivel (B2) gjuhën angleze, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në gjuhën angleze, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- e. Të ketë dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik “Profesor i asociuar” ose “Profesor”, të cilët njohin aftësinë akademike dhe profesionale të kandidatit.
- f. Të ketë notë mesatare të përgjithshme jo më pak se 8 (tetë) e lart të ciklit të dytë të studimeve, të kryera prej tij.
- g. Të marrë përsipër përmbushjen e standardeve shkencore, akademike, ligjore, etike etj.
- h. Të ketë veprimtari në lidhje me objektin e programit të studimit dhe punime treguese.
- i. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standartet shkencore dhe etike.
4. Përveç kriterëve bazë të parashikuara në pikën 3, njësitë bazë/kryesore mund të përcaktojnë kriterë shtesë si intervistë të kandidatëve të cilat miratohen në Dekanat/Senatin Akademik dhe bëhen publike përpara shpalljes së aplikimeve.

Neni 19

Procedurat për fitimin e të drejtës si student i doktoraturës

1. Studenti i interesuar mund të konkurrojë për një ose më shumë programe individuale doktorature. Kur fiton në më shumë se një është ai zgjedh kë të do të preferojë.
2. Procedurat e vlerësimit të dosjes së aplikantit nisin me ngritjen e Komisionit përzgjedhës dhe vlerësues *ad hoc*.
3. Komisioni ad-hoc zgjidhet nga Dekanati dhe përbëhet nga staf akademik i kategorisë “Profesor”. Përbërja e tij është numër tek dhe jo më shumë se 5 (pesë) anëtarë.
4. Komisioni ad -hoc, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve themelore, bën përzgjedhjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, referuar një skeme të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kriterëve.
5. Në rastet kur në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe miratuara nga Dekanati, parashikohet intervistë pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve. Vlerësimi i kryhet në dy faza të njëpasnjëshme.
6. Komisioni ad hoc pas shqyrtimit të dosjeve shpall listën me kandidatët e përzgjedhur dhe bën njoftimin për kandidatët që kalojnë në fazën e intervistës dhe cakton modalitetet e intervistës.
7. Intervista realizohet nga bashkëudhëheqësit të cilët hartojnë relacionin përkatës për çdo kandidat të intervistuar dhe ja përcjellin komisionit ad hoc si pjesë e vlerësimit të kriterëve shtesë.



8. Lista paraprake e kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni Ad-hoc, 3 ditë pas intervistës, i përcillet për miratim Dekanit përkatës, i cili shpall listën paraprake të kandidatëve fitues në faqen zyrtare të universitetit.
9. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të protokolluar pranë sekretarisë së dekanit, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të fituesve. Ankimimi paraqitet brenda 3 ditëve pune pranë Drejtuesit të Njësisë Kryesore, i cili ia përcjell Komisionit ad-hoc për shqyrtim dhe brenda 5 ditëve pune i përcjell zyrtarisht Dekanit shqyrtimin e ankimit. Dekani i Fakultetit informon ankuesin për vlerësimin e ankimit të tij.
10. Komisioni *ad hoc* pas përfundimit të periudhës së ankimit dhe shqyrtimit të ankimeve i përcjell zyrtarisht Dekanit të Fakultetit listën përfundimtare të fituesve e cila miratohet në Dekanat.
11. Dosjet e kandidatëve fitues përcillen pranë Zv/Dekanit të FESHSH-së e shoqëruar me një mbi përmbajtjen e dosjeve.

Neni 20 Dosja e aplikantit

1. Aplikanti për të fituar të drejtën e ndjekjes të programit të studimit Doktoraturë në Edukim dhe Shkencat Human, përgatit dosjen e vet, të cilën e paraqet në afatin e përcaktuar, pranë zyrës së zv/dekanit të FESHSH-së.
2. Dosja përmban:
 - a. kërkesën e aplikantit, ku përveç gjeneraliteteve saktëson programin individual për të cilin kandidon;
 - b. përvijon arritjet dhe aftësitë e veta kërkimore-shkencore;
 - c. nevojën për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi;
 - d. objektivat dhe impaktin e pritshëm nga punimi i tij kërkimor-shkencor;
 - e. mjetet dhe metodat që do të përdoren etj.
3. Aplikanti për të ndjekur programin e përbashkët të studimit të doktoratës bën një kërkesë, e cila përfshihet në dosjen personale, që dorëzohet pranë zyrës së zv/dekanit që përmban dokumentet e mëposhtme:
 - a. Curriculum Vitae;
 - b. kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
 - c. kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", diplomë specializimi ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
 - d. certifikatë lindjeje si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
 - e. dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik "Profesor i asociuar" ose "Profesor";
 - f. dëshmia e gjuhës së huaj,




- g. dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
 - h. deklaratë e gadishmërisë së udhëheqësve shkencorë për të udhëhequr kandidatin;
 - i. deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të përbashkët të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
 - j. vendimi i njësisë kryesore për fushat e kërkimit shkencor;
 - k. vendimi i njësisë kryesore për pranimin e dokumentacionit për aplikim;
 - l. propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që priten të sjellë punimi, plani kërkimor-shkencor i punës, i ndarë në vite si edhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
 - m. vërtetim nga qendra e punës, që vërteton se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
 - n. mandat pagasë për tarifën e aplikimit;
 - o. vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standartet shkencore dhe etike.
4. Deklaratën personale që nuk ndjek 2(dy) programe studimi njëkohësisht.

Neni 21

Afatet për përfundimin e procedurave deri në regjistrim

1. Afatet e procedurave deri në regjistrimin e kandidatëve fitues, nisen nga parimi i respektimit të fillimit të vitit akademik.
2. Ato parashikohen me përafërsi dhe janë relative. Rendësi ka saktësimi grafik i procedurave.
3. Dekanati miraton kuotat dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues pas propozimeve të njësisë bazë, jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit parardhës kalendarik. Kuotat i përcillen Senatit Akademik të UGJ-së për miratim.
4. Kriteret e pranimit dhe Kuotat shpallen publikisht për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron. Këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.
5. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e përbashkët të studimit të doktoratës, publikohen në faqen elektronike zyrtare si edhe në mjediset kryesore të institucionit, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.
6. Viti akademik i fillimi të veprimtarisë së këtij programi të përbashkët është 2024-2025 dhe ka veçoritë e veta objektive në kuadër të bashkëpunimit me një institucion të huaj të arsimit të lartë.
7. Për vitet e tjera akademike procedurat do të përfundojnë në fund të muajit korrik.
8. Procedurat dhe afatet miratohen çdo vit nga Dekanatet në bashkëpunim me institucionin partner dhe i përcillen Senatit Akademik për miratim.





Neni 22 Regjistrimi i kandidatëve fitues

1. Regjistrimi i kandidatëve fitues për programin të përbashkët të studimit të doktoraturës, zhvillohet në UGJ, duke bashkëpunuar për të gjitha etapat me institucionin bashkëpunues.
2. Kandidati paraqitet në sekretari duke patur me vete kartën e identitetit, dy fotografi dhe mandatpagesën për regjistrim.
3. Dekanati cakton dokumentacionin për dosjen e studentit të Doktoraturës që arkivohet në Sekretarinë Mësimore.
4. Kandidatët fitues të regjistruar në programin e përbashkët të studimit të doktoraturës i nënshtrohen procedurës përkatëse të regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23 Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të përbashkët të doktoratës

1. Kriteret bazë, që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit, janë:
 - a. Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, së paku, 3 (tri) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
 - b. Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jetë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank (SJR)* dhe/ose *Eeb of Science* me indikatorë të citimit të *Journal Citation Report (JCR)*, faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator (JCI)*, ku është së paku, autor i dytë.
2. Studenti duhet të përfundojë disertacionin, sipas formatit të përcaktuar në rregullore. Disertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe akteve të miratuara nga UGJ-ja, në lidhje me integritetin në kërkimin shkencor.
3. Të paktën një herë në vit, njësia kryesore duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës, bazuar në prezantimet vjetore të punës, që ai/ajo bën dhe vlerësimeve me shkrim që bën udhëheqësi, sipas një formati të paracaktuar.
4. Studenti duhet të përfundojë disertacionin në përputhje me kriteret dhe brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore. Disertacioni së bashku me dosjen, që përmban dokumentacionin që tregon plotësimin e kriterëve si më sipër, i dorëzohet zv/dekanit, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.
5. Studenti duhet të paraqesë Vërtetimin se ka shlyer të gjitha llojet e detyrimeve ndaj institucionit.



Neni 24
Të drejtat e studentit të doktoratës

1. Studenti ka të drejtë:
 - a. të pajiset me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore, që janë në funksion të procesit të studimeve të doktoratës dhe mbrojtjes së disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor";
 - b. të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive akademike dhe shkencore të parashikuara në programin e tij të studimeve të doktoratës;
 - c. të shfrytëzojë bibliotekën e institucioneve, në varësi të specifikave përkatëse të kërkimit;
 - d. të shfrytëzojë bibliotekat e njësive të institucioneve të tjera me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën akademike apo/dhe shkencore, duke paraqitur pranë këtyre institucioneve dokumentin e lëshuar nga njësia kryesore, mbi qëllimin e studimit të kërkimit dhe statusin e tij si student i ciklit të tretë;
 - e. të shfrytëzojë mjediset studimore/kërkimore dhe bazën e të dhënave pranë institucioneve publike/private, që do të mund t'i nevojiten atij për kërkimin shkencor, mbi bazën e rekomandimeve që njësia kryesore do të lëshojë rast pas rasti;
 - f. të tërhiqet vullnetarisht nga studimet e doktoratës, duke paraqitur kërkesën me shkrim pranë njësisë kryesore.
2. Studenti ka të drejtë të kërkojë nga Institucioni që mbulon programin e studimit garantimin prej tij të standarteve akademike, ofrimin e strukturave të domosdoshme për realizimin e projektit kërkimor shkencor dhe vënien në dispozicion të të gjitha asetëve të disponueshme që ndihmojnë kërkimin e tij cilësor në ndihmë të doktoratës, zgjerimin e dijeve dhe të metodave kërkimore.
3. Studenti, në varësi të natyrës së disertacionit, ka të drejtë të ndjekë kërkimin shkencor në të dy institucionet partnere.
4. Studenti, me aprovimin e udhëheqjes shkencore, ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e afatit të mbrojtjes së diplomës përtej afatit maksimal prej 5 (pesë) vitesh, por jo më shumë se 20% e kësaj periudhe.
5. Studenti gjatë procesit të dokturaturës, mund ta vëjë punimin e tij në shërbim të të tretëve, ose disertacioni të jetë produkt i zbatimit të një projekti në fushën e tij. Për këtë duhet të ketë dakortësinë e organeve drejtuese të programit të studimit.
6. Studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera. Në kuadrin e shpalljeve për projekte të ndryshme nga AKKSHI, apo dhe nga institucione të tjera, studenti, në kuadrin e institucionit që administron programin e studimit, mund të aplikojë për projekte të ndryshme në këto organe.



2. Doktoranti paraqet dokumentin zyrtar përkatës për origjinalitetin e punimit.
3. Kandidati mund të përdorë si pjesë më vete, në formë artikulli apo referimi, pjesë nga disertacioni i tij, para se disertacioni të mbrohet.
4. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për çdo material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës së autorit dhe akte të tjera të zbatueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen, që vjen pas titullit të punimit.

KREU IV Mbrojtja e doktoraturës

Neni 27 Rregullat për paraqitjen e disertacionit

6. Dosja e kandidatit për gradën shkencore “Doktor” duhet të përmbajë disertacionin e aprovuar nga udhëheqja shkencore.
7. Disertacioni duhet të ketë këtë format:
 - a. Të jetë në pesë kopje origjinale dhe në formë elektronike.
 - b. Kopertina duhet të përmbajë:
 - i. (në krye dhe në cepat majtas djathtas të kopertinës) logot e të dy universiteteve partnere;
 - ii. (në krye në mes të kopertinës) emrat e dy institucioneve partnere në program;
 - iii. emrat e dy fakulteteve partnerë (në mes poshtë emrit të universiteteve me logot përkatëse);
 - iv. emri i njësisë bazë që është zhvilluar programi;
 - v. fjala DISERTACION në mes të kopertinës me gërma më të dukshme;
 - vi. emri i programit të studimit të doktoratës;
 - vii. titulli i disertacionit;
 - viii. emri i kandidatit (në fund në anën e majtë të kopertinës);
 - ix. emrat dhe titujt e udhëheqjes shkencore (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
 - x. qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).
8. Dekanati përcakton në akte rregullatore specifike elementët përbërës grafikë, të formës dhe të përmbajtjes së disertacionit.



Neni 28

Formimi i jurisë për mbrojtjen e disertacionit

1. Kandidati dorëzon disertacionin së bashku me dosjen, pranë zv/Dekanit, i cili, brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit, ia përcjell për vlerësim njësisë bazë ku është realizuar disertacioni.
2. Pas vlerësimit nga njësi bazë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", brenda 30 ditëve.
3. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit (shih nenin 11).
4. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 ditëve nga formimi i saj.
5. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë.
6. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
7. Komisioni brenda 10 ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.
8. Nëse njësi bazë jep vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.

Neni 29

Funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin personelit akademik të njësisë kryesore të institucioneve bashkëpunuese.
2. Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë rregullore si dhe ka përfunduar disertacionin e tij. Ai e dorëzon disertacionin e përfunduar, së bashku me dosjen, pranë zv/Dekanit, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësi bazë të plotësimit të kriterëve formale dhe kontrollit antiplagjiaturë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.
3. Komisioni përzgjedh anëtarët e Jurisë nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë, propozuar nga njësi bazë dhe e miratuar nga Drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor". Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, ku njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet kryetar i saj.
4. Kur, për arsye të përligjura, njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i njësisë bazë vë në dijeni drejtuesin e njësisë kryesore, duke i propozuar edhe një datë tjetër për mbrojtjen. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Juria merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas



njoftimit dhe miratimit paraprak nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.

5. Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.
6. Komisioni, pasi merr Raportin e Vlerësimit nga juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 30 Mbrojtja e doktoratës

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet, si rregull, e hapur, me përjashtim të rasteve kur, për natyrën e veçantë të çështjeve të trajtuara (sekrete, të dhëna konfidenciale etj) duhet të bëhet e mbyllur. Drejtuesi i njësisë kryesore, me kërkesë të njësisë bazë, autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar, sipas propozimit të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.
2. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë.
3. Procedura e mbrojtjes së disertacionit përfshin:
 - a. Kryetari i Jurisë paraqet në hapjen e procedurave të mbrojtjes prezanton përbërjen e jurisë, dokumentacionin e dosjes së kandidatit dhe procedurën që do të ndiqet.
 - b. Kandidati për gradën shkencore “Doktor” bën prezantimin e disertacionit në jo më shumë se 25-30 minuta.
 - c. Prezantimet e oponentëve (me shkrim), konfirmojnë nëse punimi plotëson kërkesat dhe objektivat e paraqitura në platformën individuale dhe parimet e tjera të një disertacioni.
 - d. Pyetjet nga të pranishmit rreth disertacionit dhe oponentëve, drejtuar doktorantit.
 - e. Diskutime nga anëtarët e tjerë të jurisë.
 - f. Shpërndarja e fletëvotimeve të hapura dhe të paplotësuara dhe votimi i fshehtë për vlerësimin e doktoratës.
 - g. Pasqyrimi në procesverbal të rezultatit të votimit dhe shpallja e vendimit me shkrim.
4. Punimi vlerësohet me pikë, nga 0-100 pikë, 100-80% e pikëve të mundshme = “shumë mirë”, 79-65% e pikëve të mundshme = “mirë”, 64-50% e pikëve të mundshme = “mjaftueshëm”, 49% e më pak e pikëve të mundshme = “pakalueshëm”.
5. Pas mbrojtjes së disertacionit, strukturat përgjegjëse përcjellin me procesverbal një kopje të tij në Bibliotekën Kombëtare si dhe në bibliotekat e institucioneve partnere. Një kopje në formatin elektronik në UGJ dhe UMP.



Neni 31

Diploma

1. Në përfundimin me sukses të studimeve të doktoratës, lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".
2. Diploma e programit të ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës, si bashkëpunim i UGJ-së dhe UMP-së, është e përbashkët.
3. Diploma përmban elementët e përcaktuar në aktet nënligjore të dala nga ministria përgjegjëse.
4. Diploma regjistrohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
5. Diploma përmban numrin dhe datën e Vendimit të Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
6. Diploma përmban numrin në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë për diplomën përkatëse të gradës shkencore "Doktor".

Neni 32

Dorëzimi i diplomës

1. Dorëzimi i Diplomës bëhen me ceremoni të dedikuar.
2. Ceremonia organizohet dhe drejtohet nga KPKPS-ja.
3. Ftohen në ceremoninë e dorëzimit të diplomave personalitete të ndryshme të botës akademike.

Neni 33

Financimi i programit

1. Vlera e doktoratës planifikohet dhe mbulohet nga fondet për kërkim shkencor të Njesisë kryesore organizuese dhe/ose nga grantet e punës kërkimore-shkencore, që financohen nga buxheti i shtetit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi dhe/ose nga institucione të tjera financuese dhe/ose nga burime të tjera publike dhe jopublike.
2. Financimi i programit përbën detyrim të UGJ-së dhe realizohet nga:
 - a. buxheti i shtetit;
 - b. tarifat e shkollimit të studentëve;
 - c. projekte nga AKKSHI;
 - d. burime të tjera.
3. Studenti mund të vetëfinancohet, ose mund të përfitojë nga aplikime për projekte të ndryshme, nga donacione dhe bursa.



Neni 34
Dispozita kalimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i UGJ-së, pasi UGJ-ja mban përgjegjësinë e administrimit dhe financimin e programit të përbashkët të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës "Edukimi dhe shkencat humane".

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Gjirokastrës.

Grupi i punës :

Prof.asoc Valbona Duri

Dekan i FESHSH-së

Prof.dr Gëzim Sala

Zëvendës Rektor për çështjet akademike dhe zhvillimin
Institucional

Prof.asoc Merita Isaraj

Zëvendës Rektor për koordinimin ndërkombëtar dhe
kërkimin shkencor

Prof.asoc Mimoza Çarka

Përgjegjës njësia bazë e Edukimit dhe Metodologjisë
së Mësimdhënies.

Prof.asoc Joana Taçi

Përgjegjës njësia bazë e Gjuhëve të Huaja

Prof.asoc Panajot Barka

Koordinator i Programit të përbashkët të studimit

Doktoratë në Edukim dhe Shkencat Humane

Klaviora Dudumi

Drejtor i DSKMT-së

